



REPUBLICA E KOSOVES REPUBLIKA KOSOVA REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Dep. Dep. Dep.	DPKI
Nr. Prot. Bashk. Prot. No.	06-01/2103/22
Nr. f. fac. Broj. stranica Nr. pages	02
Dat. Datum Date	13-05-2022
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosovo**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Në mbështetje të nenit 11, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, nenit 5, paragrafi 1 pika 1.5, nenit 18, paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, si dhe nenit 7 paragrafi 4 të Rregullores nr. 01/2018 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores Nr. 01/2014 dhe Rregullores Nr. 01/2017 të Punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 13.05.2022, mori këtë:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti me nr. AKK-DPKI-06-2595/21, për zyrtarin e lartë z. Fadil Gashi, Deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, për shkak të është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrim të funksionit publik.
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë, në rast se paraqiten rrethana të reja.

**A r s y e t i m**

I. Pas identifikimit të rastit lidhur me papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik, Agjencia kundër Korrupsionit (në tekstin e mëtutjeshëm: Agjencia), ka hapur rastin me numër protokollit AKK-DPKI-06-2595/21, për zyrtarin e lartë z. Fadil Gashi, Deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, duke zhvilluar procedurën e paraparë sipas Ligjit nr.06/L-01, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funksionit Publik (në tekstin e mëtutjeshëm: Ligji për Parandalimin e Konfliktit të Interesit).

Agjencia ka filluar trajtimin e rastit në fjalë, duke bërë fillimisht verifikimin dhe konfirmimin e këtij informacioni në institucionet përkatëse, prej nga rezultoi se z. Fadil Gashi, krahas ushtrimit të funksionit si zyrtar i lartë publik, respektivisht Deputet i Parlamentit të Republikës së Kosovës, njëkohësisht është edhe Përfaqësues i Autorizuar në Biznesin “Fadil Me. Gashi” B.I.

Më pas, në pajtim me nenin 22, paragrafin 3 dhe 5 të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, Agjencia përmes shkresës zyrtare DPKI-06-01/1853/22, e ka njoftuar zyrtarin e lartë për fillimin e shqyrtimit të gjendjes së papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit.



Pas pranimit të kësaj shkrese, pala ka kontaktuar zyrtarin përgjegjës të Agjencisë dhe ka kërkuar një takim sqarues, i cili takim është realizuar dhe me këtë rast pala është njoftuar lidhur me rastin në fjalë, duke i sqaruar se gjatë ushtrimit të funksionit publik, në cilësinë e zyrtarit të lartë publik, ai nuk mundet që njëkohësisht të jetë Përfaqësues i Autorizuar në biznes, sepse kjo situatë paraqet gjendje të papajtueshmërisë me ushtrimin e funksionit publik, siç përcaktohet me nenin 13, paragrafi 1, të Ligjit për Parandalimin e Konfliktit të Interesit, ku thuhet se:

*1. "Zyrtari i lartë nuk mund të jetë menaxher, përfaqësues i autorizuar ose anëtar i ndonjë organi menaxhues apo mbikëqyrës i personave juridikë privatë, fitimprurës sipas ligjit përkatës për shoqëritë tregtare dhe organizatave joqeveritare, përjashtuar subjektet e përcaktuara në nenin 14 të këtij ligji, subjektet politike si dhe rastet kur një funksion i tillë i dedikohet me ligj për shkak të funksionit".*

Pas diskutimit dhe ballafaqimit të fakteve, zyrtari i lartë z. Fadil Gashi është pajtuar me gjetjet e Agjencisë, duke deklaruar se do të ndërmarr veprime të menjëhershme dhe konkrete në mënyrë që të shmang papajtueshmërinë në ushtrimin e funksionit publik.

Ndërkohë, Agjencia ka pranuar shkresën zyrtare (DPKI-06-01/1854-1/22), me të cilën dëshmohet se zyrtari i lartë z. Fadil Gashi ka bërë ndryshimet e kërkuara nga Agjencia dhe se i njëjti nuk figuron më të jetë Përfaqësues i Autorizuar në biznesin privat "Fadil Me. Gashi" B.I.

Me veprimet e ndërmarra nga zyrtari i lartë, janë krijuar rrethana të reja me çfarë është shmangur gjendja e papajtueshmërisë, përkatësisht konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik për zyrtarin e lartë.


Prandaj, në bazë të asaj që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

II. Në mbështetje të nenit 18, paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë, nëse paraqiten rrethana të reja.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik,
- Drejtorit të DPKI-së,
- Zyrtarit përgjegjës.

Drejtor i Agjencisë kundër Korrupsionit



Ylli Buleshkaj  
Ylli Buleshkaj  
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT  
REPUBLIKË E KOSOVËS